

Rekomandime të dala nga Komponenti Nr 4.

Titulli: Testimi i varieteteve të reja bimëve kryesore foragjere, fasules, lulediellit, prodhimi i farës parabazë të tyre, ruajtja dhe shumëzimi i materialeve gjenetike të vendit.

Qëllimi : Qëllimi i këtij komponenti është rinovimi i strukturës varietore të mbjelljeve të bimëve kryesore foragjere dhe fasules, nëpërmjet provave të testimit, prodhimi i farës parabazë të tyre, ruajtja dhe shumëzimi i materialeve gjenetike autoktone dhe divulgimi i të dhënave në fermë nëpërmjet botimeve, seminareve, trajnimeve dhe mjeteve të tjera të informacionit..

Rekomandimet të pjeshme;

Rekomandimi Nr.1.Të vazhdojë puna për ruajtjen, rigjenrimin dhe shtimin e materialeve autoktone të bimëve kryesore foragjere (jonxhë, lotus, tërfil njëvjeçarë, tërshërë, elb, sorgum, lolium) dhe bimëve të tjera bishtajore për kokërr (fasule, bisele, foragjere, bathë, qiçërr, koçkull).

Rekomandimi Nr.2.Të filloje puna me prodhimin e farës së certifikuar në fermë, për bimën e jonxhës, në mënyrë që në vitin 2013 të mbillet rreth 20% e sipërfaqes me gjeneracion të dytë.

Rekomandimi Nr.3. Të fillijë puna për prodhimin e farës së certifikuar në fermë për bimën e tërshërës në mënyrë që në shkallë vendi të mbillet me farë të gjeneracionit të dytë rreth 50% e sipërfaqes të mbjellë me këtë bimë deri në vitin 2012.

Rekomandimi Nr.4.Të filloj puna për prodhimin e farës së certifikuar në fermë Në bimët lolium multiflorum dhe tërfil aleksandrin të filloj prodhimi i farës së certifikuar, në mënyrë që brenda vitit 2013 50 % e sipërfaqes të mbjellë me këto bimë të jetë e gjeneracionit të dytë

Rekomandimi Nr.5. Të vazhdojë studimi i varieteteve të reja të tërshërës edhe për një vit dhe më pas të kërkohet rregjistrimi i varietetit më të mirë në Katalogun Kombëtar të Varieteteve. Gradualisht të filloj përhapja e varieteteve. Abed Minor, Argus, Torpan.

Rekomandimi Nr.6. Krahas kultivarit Shijak, për mbjelljet direkte të bimës së fasules të fillojë përhapja gradualisht e linjave të reja L.32- 21 dhe L 232.

Rekomandimi Nr.7. Në mungesë të farës së varietetit Tomin, ndër varietetet e huaja të përdoren Prosement Bologna dhe Marshall, të pranishëm në tregun e farërave. Puna të vazhdoj edhe në të ardhmen për skrinimin (vlerësimin) e varieteteve të tjera të huaja që janë në tregun e farës.

Drejtuesi i Komponentit

Asllan Celami